

# **INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN ME MJEDISIN TË PROJEKTIT**

**“BENAKS-94” sh.p.k.**

**SHFRYTËZIM I MINERALIT TË KUARCIT**

**ZONA MINERARE Nr. 59/3**

**OBJEKTI "BLACË", POGRADEÇ, QARKU KORÇË**

Ky informacion u hartua sipas VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore”

a) **një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit**

Vendi ku kerkohet leja e shfrytezimit eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia. Rriten vetem pak shkurre te vogla si dhe dushqe ku lartesia e tyre nuk i kalon 1.2 m etj. Ne zonen e dherave qe ne rastin tone eshte shume e vogel (mbuleses qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike) rriten lule dhe bar. Terreni eshte kryesisht shkembor, gje qe e ka bere kete zone, te perfshihet ne plan minerar vjetor te MEI-t.



Objekti ndodhet 1 km larg Zones se Mbrojtur "Liqeni i Pogradecit", por nuk e cenon peisazhin perreth. Gjithesesi shoqeria mirepret cdo sugjerim apo kusht qe do te vihet ne Deklaraten Mjedisore.

b) **informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj**

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Brenda kufijve te zones qe kerkohet ne kuotat e poshteme nuk vihet re prania e ndonje burimi uji. Brenda siperfaqes ku kerkohet leja minerare ndodhen prroska te krijuara nga erozioni. Ato kane thellesi te ndryshme dhe ne stinen e thate ne to nuk nuk rrjedhin ujra. Kur ka reshje, per shkak dhe te pjerresise mjaft te madhe te terrenit, neper to rrjedhin ujra siperfaqesore.

c) **një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër**

**1. Humbje e tokes per kullote**

Siperfaqja e pergjitheshme qe do te zeje objekti gjate shfrytezimit eshte 1km<sup>2</sup>. Ajo nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson ndonje kullote . Ne prefundim te shfrytezimit kjo siperfaqe do te sistemohet dhe mbillet me qellim riperdorimin e saj . E gjithe zona do te mbulohet me formacionet deluviale te zbulimit duke mundesuar keshtu, pas perpunimit, kultivimin e pemeve te ndryshme lokale dhe barishteve. Si rrjedhim pas shfrytezimit nuk do te kemi humbje te siperfaqes per kullote

**2.Humbje e pjerresise se tokes**

Ne projekt, pjeresia skarpatave te shkalleve eshte parashikuar te jete 68-70<sup>0</sup> . Kjo pjeresi eshte me e madhe se ajo natyrale e terenit te objektit, por duhet te kihet parasysh se kjo pjerresi eshte e pranishme vetem per 5

shkallet e para. Per shkallet e tjera eshte shume me e ulet. Per te dy raste kendi i shuarajes se shkalleve eshte nen 50 grade. Mbas sistemimit perfundimtar dhe mbushjes do te tentohet qe ai te ulet edhe  $10^0$  te tjera Humbja e pjerese se tokes nga shfrytezimi nuk do e jete e konsiderueshme

### **3. Ndotja e tokes nga rrjedhjet**

Ne projektin e shfrytezimit jane percaktuar masa si pjerese e shesheve te punes, kalalet e ndryshme ne ane te rruges etj te cilat do te mundesojne dekantimi llumrave te pakta ne ujra brenda kufijve te shfrytezimit. Ne stinen e thate keto dekantime do te ngarkohen dhe transportohen ne vendin e depozitimit te dherave.

### **4. Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta**

Sasi e sterileve te zbulimit, perkohesisht do te depozitohet ne siperfaqet e parashikuara ne projekt dhe me vone do te ritransportohen dhe depozitohen ne sheshet e shkalleve dhe ne sheshin e poshtem +210m. Ato perfaqesohen nga deluvione te shkriфта, qe nuk permbajne elemente ndotes per ambientin . Keto depozitime jane fertile dhe do te sherbejne me se miri per rigjenerimin e karrieres

### **5. Ndotja e tokes nga depozitimi i llumrave**

Gjate shfrytezimit te objektit nuk parashikohet depozitime llumrash . Ato, qe ne sasi shume te pakta do te krijohen gjate rreshjeve do te depozitohen brenda karrieres dhe do te riperdoren ne prodhimin e tullave.

### **6. Errozioni gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit minerar.**

Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin, shembjen dhe vithisjen e shapateve te karrieres dhe siperfaqes se tokes rreth saj.

### **7. Bimet e ujit**

Ne zone ku do te ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit nuk ka asnje lloj bime uji

### **8. Flora dhe fauna**

Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mabrohet me sataus te veçante . Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nag shfrytezimi, mbasi siperfaqja e objekti eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia. Rrigjenerimi i karrieres do te mundesoje mbjelljen e bimeve lokale

### **9. Trajtimi i ujrave**

Teknologjia shfrytezimit te objektit nuk parashikon perdorimin e ujit . Ujrat e reshjeve do te dekantohen negropa brenda zones se shfrytezimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre me ane te nje kanali ne ane te rruges se hapjes deri ne kanalim e rruges se poashteme

### **10. Zhurmat gjate punes se hapjes**

Burimi kumuluar i zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte 180 dB. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacinin me poshtem :

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

$L$  - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate .  $I_1$  - Intensiteti

akustik i zhurmave te kumuluara

$I_0$  - Intensiteti akustik i references

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe ipergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te , praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000Hz , e cila e shte e pranueshme nga veshi i njeriut .

### **13. Prodhimi i mbeturinave dhe depozitimi i materialve qe krijohe gjate hapjes dhe shfrytezimit te**

## **objektit**

Gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit do te kete vetem depozitim paraprak te rreth 17340m<sup>3</sup> sterile te cilat do te kthehen. ne perfundim te shfrytezimit brenda kufijve te karrieres.

### **c) një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;**

Me qene se projekti parashikon rrezimin e materialit me perdorim te L.P., proceset e rrezimit dhe ngarkimit do te shoqerohen me sperkatje per parandalimin e pluhurit

Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve , mbetje toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme

### **d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;**

Keto ndikime do te jene te perkohshme, pasi subjekti do te marre te gjitha masat per minimizimin e tyre. Pritshmeria me e madhe do te jete emetimi i pluhurave gjate fraksionimit te gurit gelqeror, 1 ose 2 ore ne dite. Por gjate gjithe kohes do te punohet me sprucim, per te ulur nivelin e emetimeve.

### **dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;**

Objekti ndodhet ne maje te nje kodre dhe eshte larg zonave te banuara. Nuk kemi te bejme me perdorim te lendeve te rrezikshme helmuese, nuk do te kemi shkarkime ne burime ujore apo dergime mbetjesh ne vende te tjera. Rrjedhimisht nuk kemi shtrirje hapsinore te ndikimit negativ.

### **e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;**

Lidhur me planin e rehabilitimi, eshte parashikuar qe ai te behet paralelisht me shfrytezimin, pra jo ne fund te karrieres.

Me poshte, jepet ne vlere monetare rehabilitimi i karrieres:

1. Shpenzimet per mbylljen dhe rehabilitimin e 1 ha kariere per pjesen e shfrytezuar me siperfaqe rezulton 322 750 leke/ha
2. Shpenzimet per çmontimin, ngarkim dhe transport impianti e impiantit 563129 leke -322750leke = 240379 leke
3. Ne siperfaqen e pergjithshme horizontale qe do te trajtohet eshte marre ne konsiderate:
  - ✚ Siperfaqja e mbetur nga shfrytezimi i gelqerorit ne dhjetevjeçarin e pare 1.845ha;
  - ✚ Siperfaqja qe do te preket nga shfrytezimi i gelqerorit ne dhjetevjeçarin e dyte 17.6 ha;
  - ✚ Siperfaqe e rruges kryesore dhe rrugeve lidhese 7370mx5 m= 3.685 ha
  - ✚ Siperfaqja totale per rehabilitim rezulton 23.13 ha
4. Shpenzimet e pergjithshme per mbylljen, trajtimin e mbetjeve dhe stoqeve dhe rehabilitim e zones se shfrytezuar rezultojne 7465210 leke
5. Shpenzimet e pergjithshme per çmontimi i impiantit te perpunimit, prishja e objekteve siperfaqesore etj 240379 leke
6. Shuma totale per mbyllje rehabilitim te objektit 7705610 leke
7. Garancia vjetore e mjedisit 770560 leke

### **ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;**

Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytezimit te objektit konsistojne ne :

1. Krijimin e siperfaqeve per mbjellje;

2. Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres;
3. Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane pishe dhe barishte te ndryshme;
4. Mirmbajtjen e siperfaqeve te mbjella;
5. Siperfaqja horizontale qe do te rigjenerohet nga objekti gjate gjithe aktivitetit te tij do te jete  $0.0957\text{km}^2$

**f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).**

Ky projekt ndodhet brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe nuk ka ndikime ne mjedisin kufitar.